



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva-Ministry of Health

PROJEKTLIGJI PËR SHËNDETËSI

DRAFT HEALTH LAW

NACRT ZAKONA O ZDRAVSTVU

KUVENDI I KOSOVES	ASSEMBLY OF KOSOVO	SKUPŠTINA KOSOVA
<p>Në mbështetje të nenit 65 (1) Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Miraton:</p>	<p>Pursuant to article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, Hereby adopts the:</p>	<p>Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo, Usvaja:</p>
<p>LIGJI PËR SHËNDETËSI</p>	<p>HEALTH LAW</p>	<p>ZAKON O ZDRAVSTVU</p>
<p>Kreu I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME</p>	<p>Chapter I BASIC PROVISIONS</p>	<p>Poglavlje I OPŠTE ODREDBE</p>
<p>Neni 1 Qëllimi i ligjit</p>	<p>Article 1 Purpose of the law</p>	<p>Član 1 Cilj zakona</p>
<p>Ky ligj ka për qëllim sigurimin e bazës ligjore për rregullimin dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore të qytetarëve të Republikës së Kosovës nëpërmjet promovimit të shëndetit, aktiviteteve parandaluese, dhe ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe kualitative të kujdesit shëndetësor.</p>	<p>This law has the aim of establishing legal grounds for the regulation and the improvement of the health status of the citizens of the Republic of Kosovo through health promotion, preventive activities and provision of comprehensive and quality healthcare services.</p>	<p>Ovaj zakon ima za cilj obezbeđenje zakonske osnove za regulisanje i poboljšanje zdravstvenog stanja građana Republike Kosova, putem promovisanja zdravlja i preventivnih aktivnosti, usmerenih na pružanje sveobuhvatnih i kvalitetnih usluga zdravstvene zaštite.</p>
<p>Neni 2 Fushëveprimi</p>	<p>Article 2 Scope</p>	<p>Član 2 Delokrug</p>
<p>1. Me këtë ligj përcaktohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Të drejtat dhe detyrimet në fushën e shëndetësisë; 1.2 Parimet e kujdesit shëndetësor; 1.3 Sistemi i kujdesit shëndetësor; 1.4 Veprimtaria e institucioneve shëndetësore; 1.5 Mbikëqyrja e shërbimeve shëndetësore. 	<p>1. This Law defines:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1 Rights and obligations in the field of health; 1.2 The healthcare principles; 1.3 The healthcare system; 1.4 Healthcare institutions' activities; 1.5 Supervision of healthcare services. 	<p>1. Ovim zakonom se utvrđuju:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1.1 prava i obaveze u oblasti zdravstva; 1.2 načela zdravstvene zaštite; 1.3 sistem zdravstvene zaštite; 1.4 delatnost zdravstvenih institucija; 1.5 nadzor zdravstvenih usluga.

<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizime</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p>
<p>1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:</p> <p>1.1 Qeveria, nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës;</p> <p>1.2 Ministria, nënkupton Ministrinë e Shëndetësisë;</p> <p>1.3 Komuna, nënkupton njësinë themelore territoriale të vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.4 Qytetari, personi me shtetësi të Republikës së Kosovës sipas Ligjit mbi Shtetësinë e Kosovës, ose personi i kualifikuar si refugjat në pajtim me ligjin;</p> <p>1.5 Banori, bartësi i lejes së qëndrimit në territorin e Republikës së Kosovës të lëshuar nga autoriteti kompetent, si edhe personi me status zyrtar të refugjatit;</p> <p>1.6 Shfrytëzuesi i shërbimeve shëndetësore, është personi i cili i shfrytëzon shërbimet shëndetësore;</p> <p>1.7 Anëtar i familjes së ngushtë, është bashkëshorti/ja, fëmiju, fëmiju i adoptuar, prindi (thjeshtri, njerka), vëllau dhe motra, deri në moshën 18 vjeçare;</p>	<p>1. Definitions mentioned in this law have the following meanings:</p> <p>1.1 The Government, the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2 The Ministry, the Ministry of Health;</p> <p>1.3 Municipality, the basic territorial unit of local self-governance in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.4 The citizen, person with citizenship of the Republic of Kosovo according to the Law on Citizenship of Kosovo, or person qualified as a refugee in compliance with the law;</p> <p>1.5 Resident, a bearer of a stay permit issued by the competent authority, for the territory of the Republic of Kosovo as well as the person with official refugee status;</p> <p>1.6 User of healthcare services, a person using the healthcare services;</p> <p>1.7 Close family member, the spouse; the child adopted child; parent (step-father, step-mother); brother and sister, up to the age of 18;</p>	<p>1. Upotrebljeni izrazi u ovom zakonu imaju ova značenja:</p> <p>1.1 Vlada, podazumeva Vladu Republike Kosova;</p> <p>1.2 Ministarstvo, porazumeva Ministarstvo zdravstva;</p> <p>1.3 Opština, podrazumeva osnovnu samoupravnu teritorijalnu lokalnu jedinicu u Republici Kosova;</p> <p>1.4 Gradanin, osoba sa državljanstvom Republike Kosova saglasno sa Zakonom o državljanstvu Kosova, ili osoba koja je kvalifikovana kao izbeglica u saglasnosti sa zakonom;</p> <p>1.5 Stanovnik, posednik dozvole za prebivalište na teritoriji Republike Kosova izdate od strane nadležnog autoriteta, kao i osoba koja je kvalifikovana kao izbeglica u saglasnosti sa zakonom;</p> <p>1.6 Korisnik zdravstvenih usluga je osoba koja koristi zdravstvene usluge;</p> <p>1.7 Član uže porodice je bračni partner, dete, adaptirano dete, roditelj (maćeha ili očuh), brat i sestra dok ne napune 18 godina.</p>

<p>1.8 Personi me aftësi të kufizuar, është personi me aftësi përkohësisht ose përherë dhe plotësisht të kufizuar i cili ka më shumë se 18 vite dhe më pak se 65 vite; që ka diagnozën mjekësore të gjendjes së tillë: fizike, ndijore, dhe mendore; të sëmundjes ose të aftësisë së kufizuar, që e bënë atë të paafte për çfarëdo pune shpërblyese, dhe për të cilin, pas vlerësimit profesional, Ministria përkatëse ka marr vendim se i përmbush kriteret e përcaktuara me ligj;</p> <p>1.9 Invalidi i punës, është personi të cilit në pajtim me ligjin i është njohur e drejta e invaliditetit të punës;</p> <p>1.10 Invalidi i luftës, është pjesëtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilit në pajtim me ligjin i është njohur e drejta e invaliditetit si pasojë e luftës;</p> <p>1.11 Invalidi civil i luftës, është personi të cilit nga organi kompetent i është njohur e drejta e invaliditetit si pasojë e luftës dhe burgosjes politike;</p> <p>1.12 Agjensioni i Financimit Shëndetësor (AFSH), është agjencion ekzekutiv i Ministrisë</p>	<p>1.8 Person with special needs, a person with temporary or permanent and full disability older than 18 and under 65, who has the medical diagnosis of a such physical, sensory and mental state; of the illness or disability, which makes him unable to have any profitable job and for which, after the professional assessment the relevant Ministry has taken the decision that it fulfills the criteria set by the law;</p> <p>1.9 Work disabled person, a person who based on the law is recognized the right on work disability;</p> <p>1.10 War disabled person, a member of the Kosovo Liberation Army, who based on the law is recognized the right on disability due to the war;</p> <p>1.11 Civilian war disabled person, is the person who is recognized the right on disability as a consequence of war and political imprisonment;</p> <p>1.12 Health Financing Agency (HFA), executive Agency under the authority of the Ministry with</p>	<p>1.8 Lice sa ograničenim sposobnostima je lice sa stalno i potpuno ograničenim sposobnostima koji ima više od 18 godina i manje od 65 godina; koje ima medicinsku dijagnozu takvog stanja: fizičke, osetne i mentalne bolesti ili ograničene sposobnosti, koja istog čini nesposobnim za bilo koji nagrađeni rad; za koju je posle profesionalne ocene, Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite donelo odluku da ispunjava kriterijume utvrđenim zakonom;</p> <p>1.9 Invalid rada je lice kome je odobreno pravo na invalidnost rada u skladu sa zakonom;</p> <p>1.10 Ratni invalid je pripadnik Oslobođilačke vojske Kosova, kome je odobreno pravo na invalidnost kao posledica rata, u skladu sa zakonom;</p> <p>1.11 Civilni invalid rata, zbog zatvora i političkog progona "je lice kome je odobreno pravo na invalidnost kao posledica rata i političkog zatvora“;</p> <p>1.12 Agencija za finansiranje zdravstva(AFZ), je izvršna agencija Ministarstva koja u ime države</p>
---	---	--

<p>që në emër të shtetit realizon të drejtat, obligimet, përgjegjësitë, dhe autorizimet përkitazi me kontraktimin, blerjen, e shërbimeve të kujdesit shëndetësor nga institucionet shëndetësore në të gjitha format e pronësisë, si dhe grumbullimin e të gjitha mjeteve financiare për këtë qëllim. Themelimi, organizimi, dhe funksionimi i AFSH do të rregullohet me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Qeveria.</p> <p>1.13 Lista e barërave dhe materialit shpenzues, është Lista e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese që mbulohen nga Qeveria dhe bashkë-pagesat e qytetarëve;</p> <p>1.14 Bashkë-pagesa, nënkupton mjetet financiare që paguhen nga qytetarët dhe banorët të cilët në pajtim me këtë ligj nuk janë të liruar nga bashkë-pagesat me rastin e shfrytëzimit të shërbimeve shëndetësore në institucionin publik, privat, ose publiko-privat shëndetësor, të kontraktuar nga AFSH;</p> <p>1.15 Lista e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, është Lista e formave dhe llojeve të</p>	<p>rights, obligations, responsibilities, and authorizations regarding contracting, buying healthcare services from healthcare institutions in all forms of ownership on behalf of the state, as well as pooling all financial means for this purpose. The establishment, organization, and functioning of the HFA shall be regulated with the sub-legal act issued by the Government.</p> <p>1.13 List of drugs and medical consumables, the List of medical products and medical consumables covered by the Government and by co-payments;</p> <p>1.14 Copayment, financial means paid by citizens and residents whom by this law are not exempted from copayments for use of healthcare services in public, private, or public-private healthcare institutions contracted by the HFA;</p> <p>1.15 List of healthcare services, list of forms and types of health care services that shall be covered by</p>	<p>realizuje prava, obaveze, odgovornosti i ovlašćenja u pogledu ugovaranja, kupovina u vezi sa zdravstvenim uslugama od strane zdravstvenih ustanova u svim oblicima svojine, i prikuplja finansijska sredstva za ovu svrhu. Osnivanje, organizacija i funkcionisanje AFZ će se regulisati podzakonskim aktima donetim od strane Vlade.</p> <p>1.13 Osnovna lista lekova i potrošnog materijala je lista medicinskih proizvoda i sanitarnog potrošnog materijala koji se nadoknađuju od strane Vlade i participacije građana.;</p> <p>1.14 Participacija, podrazumeva finansijska sredstva koja uplaćuju građani i stanovnici koji saglasno sa Zakonom o zdravstvu nisu oslobođeni od participacije za korišćenje zdravstvenih usluga u javnoj ili privatnoj zdravstvenoj instituciji koja ima ugovor sa AFZ;</p> <p>1.15 Lista usluga zdravstvene zaštite, podrazumeva Listu oblika i vrsta usluga zdravstvene zaštite koji se</p>
--	---	---

<p>shërbimeve të kujdesit shëndetësor që mbulohen nga Qeveria dhe nga bashkë-pagesat (përfshirë Listën e produkteve mjekësore dhe materialeve shpenzuese) e cila përpilohet nga komiteti teknik i emëruar nga Ministria. Lista mund të modifikohet sipas nevojës në bazë të vlerësimit të Ministrisë.</p> <p>1.16 Profesionisti shëndetësor, është punëtori që ofron shërbime shëndetësore;</p> <p>1.17 “I diplomuar”, personi që ka përfunduar me sukses studimet themelore universitare;</p> <p>1.18 Specialist, nënkupton kualifikimin profesional të fituar gjatë edukimit specialistik pas-diplomik, të kryer në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.19 Sub-specialist, nënkupton kualifikimin e ngushtë profesional të fituar gjatë edukimit pas-specialistik në Republikën e Kosovës ose jashtë saj, që është i njohur dhe i nostrifikuar nga organi i autorizuar ose i njohur në pajtim me këtë ligj;</p>	<p>the Government and by copayments (including the list of drugs and medical consumables), developed based on agreed criteria by a technical committee appointed by the Ministry. The List can be modified as needed upon the assesment of the Ministry.</p> <p>1.16 Health professional, a worker providing healthcare services;</p> <p>1.17 Graduated, a person who has successfully completed his university studies;</p> <p>1.18 Specialist, professional qualification gained during post-graduate specialist education carried out in the Republic of Kosovo or abroad, recognized and verified in compliance with this law;</p> <p>1.19 Sub-specialist, narrow professional qualification gained during post-specialist training in the Republic of Kosovo or abroad, recognized and verified by the authorized or recognized authority in compliance with this law;</p>	<p>nadoknađuju od strane Vlade i participacije (uključujući lekove i potrošni materijal), koju sastavlja tehnički komitet imenovan od strane Ministarstva. Lista se može menjati po potrebi na osnovu procene Ministarstva.</p> <p>1.16 Zdravstveni stručnjak je radnik koji pruža zdravstvenu uslugu;</p> <p>1.17 Diplomirani je osoba koja je uspešno završila univerzitetske studije;</p> <p>1.18 Specijalista, podrazumeva stručnu kvalifikaciju stečenu tokom specijalističkog postdiplomskog obrazovanja na teritoriji Kosova ili u inostranstvu, a koja se priznaje i nostrifikuje u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.19 Sub-specijalista, podrazumeva stručnu kvalifikaciju stečenu tokom stalnog stručnog usavršavanja, nakon specijalističkog obrazovanja u Republici Kosova ili u inostranstvu, a koja se priznaje i nostrifikuje od strane ovlašćenog ili priznatog organa u skladu sa ovim zakonom;</p>
--	---	--

<p>1.20 Bashkëpunëtori shëndetësor, është personi i cili nuk e ka kryer shkollimin formal medicinal, që me qëllim të realizimit të veprimtarisë shëndetësore është i punësuar në institucion shëndetësor;</p> <p>1.21 Shërbimi shëndetësor i burgjeve të Republikës së Kosovës, është shërbim autonom profesional, që në mënyrë të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse kujdeset për shëndetin e qytetarëve dhe banorëve të vendosur në institucionet korrektuese;</p> <p>1.22 Kujdesi shëndetësor, nënkupton masat dhe veprimet që ndërmerren nga organizatat, institucionet, dhe profesionistët shëndetësor, që për qëllim parësor kanë përmirësimin e shëndetit të qytetarëve dhe të banorëve;</p> <p>1.23 Mjekësia familjare, nënkupton kujdesin personal, gjithëpërfshirës, dhe të vazhdueshëm për individin në kontekstin e familjes dhe bashkësisë</p> <p>1.24 Shërbimi profesional, është organizimi administrativ dhe profesional i institucioneve</p>	<p>1.20 Health co-worker, a person working in healthcare institutions who has not completed the formal medical education, but who is employed in a healthcare institution with the aim of realizing health activities;</p> <p>1.21 Healthcare services in prisons in the Republic of Kosovo, a professional autonomous health service, taking care continuously and comprehensively for the health of the citizens and residents placed in correctional institutions;</p> <p>1.22 Healthcare, the measures and activities undertaken by organizations, institutions and health professionals with the primary purpose to improve the health of the citizens and residents;</p> <p>1.23 Family medicine, personal, comprehensive and continuing care for the individual in the context of the family and the community;</p> <p>1.24 Professional service, the administrative and professional organization of healthcare</p>	<p>1.20 Zdravstveni saradnik je osoba koja radi u zdravstvenoj ustanovi, koja nije završila formalno zdravstveno obrazovanje, a koja pomaže u obavljanju delatnosti zdravstvene zaštite;</p> <p>1.21 Zdravstvena služba zatvora Republike Kosova je samostalna profesionalna zdravstvena služba, koja se na stalan i sveobuhvatan način brine za zdravlje svih građana smeštenih u korektivnim institucijama;</p> <p>1.22 Zdravstvena zaštita, podrazumeva mere i radnje preduzete od strane zdravstvenih organizacija, institucija i profesionalnih stručnjaka koje imaju kao primarni cilj unapređenje zdravlja građana;</p> <p>1.23 Porodična medicina, podrazumeva osobnu, sveobuhvatnu, i stalnu brigu za pojedinca u kontekstu porodice i zajednice;</p> <p>1.24 Profesionalna služba je administrativna i profesionalna organizacija zdravstvenih institucija u</p>
---	--	---

<p>shëndetësore brenda një lëmie specialistike, që ka për qëllim sigurimin e vazhdimësisë së kujdesit shëndetësor në të gjitha nivelet e organizimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor;</p> <p>1.25 Institucioni shëndetësor, është institucioni i themeluar nga personi juridik ose fizik që ofron shërbime të kujdesit shëndetësor, në bazë të licencës së lëshuar në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.26 Institucioni shëndetësor humanitar, është institucioni shëndetësor i themeluar nga organizata joqeveritare dhe jopërfituese me seli në Republikën e Kosovës që është e autorizuar për veprimtari shëndetësore;</p> <p>1.27 Themelues, është Ministria, Kuvendi i Komunës si dhe personat fizik dhe juridik, të cilët kanë të drejtë të themelojnë institucionin shëndetësor në pajtim me këtë ligj;</p> <p>1.28 Dokumentacioni mjekësor, nënkupton dorëshkrimet, shënimet ose të dhënat e tjera përkitazi me identitetin personal të shfrytëzuesit të shërbimeve</p>	<p>institutions within one specialist field aiming to provide continuous healthcare at all levels of the healthcare services organization;</p> <p>1.25 Healthcare institution, is institution established by juridical or physical persons providing healthcare services under a working license issued in compliance with this law;</p> <p>1.26 Humanitarian healthcare institution, a healthcare institution established by non-governmental and non-profitable organizations in the Republic of Kosovo authorized to provide healthcare services;</p> <p>1.27 Founder, Ministry, Municipal Assembly and natural persons and legal entities having the right to establish a healthcare institution in compliance with this Law;</p> <p>1.28 The health documentation, the manuscripts, records and the data collected, regarding the personal identity of the healthcare user and his health status accessible to the</p>	<p>okviru jedne specialističke oblasti, koja ima za cilj obezbeđivanje trajne zdravstvene zaštite na svim nivoima zdravstvene zaštite;</p> <p>1.25 Zdravstvena institucija je institucija osnovana od strane pravnog ili fizičkog lica koja pruža usluge zdravstvene zaštite na osnovu dozvole izdate u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.26 Humanitarna zdravstvena institucija je zdravstvena institucija osnovana od strane nevladinih i neprofitabilnih organizacija sa sedištem na Kosovu koja je ovlašćena za zdravstvenu delatnost;</p> <p>1.27 Osnivač je Ministarstvo, Skupština Opštine i fizička i pravna lica koja imaju pravo na osnivanje zdravstvene ustanove u skladu sa ovim zakonom;</p> <p>1.28 Zdravstvena dokumentacija, podrazumeva rukopise, beleške ili druge podatke o ličnom identitetu korisnika zdravstvenih usluga i njegovom zdravstvenom stanju u</p>
---	---	---

<p>shëndetësore dhe gjendjes së tij shëndetësore në të cilat ka qasje profesionisti shëndetësor gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore;</p> <p>1.29 Fshehtësia profesionale, nënkupton ruajtjen e të dhënave për gjendjen shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore nga qasja në to prej personave të paautorizuar;</p> <p>1.30 Urgjenca, nënkupton ndryshimin e përnjëhershëm të gjendjes shëndetësore që në rast të mungesës së ofrimit të shërbimit të shpejtë shëndetësor rrezikon jetën ose dëmton seriozisht shëndetin e qytetarit ose banorit;</p> <p>1.31 Gjendja e urgjencës, është çdo lloj ngjarje e paparashikueshme që rrezikon jetën, integritetin fizik dhe shëndetin e qytetarëve dhe banorëve ose funksionimin e institucioneve shëndetësore, që cilësohet me shpërputhje të madhe ndërmjet nevojave për kujdesin shëndetësor dhe mundësive në dispozicion;</p> <p>1.32 Sterilizimi artificial, është procedura mjekësore që ka për qëllim humbjen e aftësisë së mbarësimit;</p>	<p>health professional during the provision of healthcare services;</p> <p>1.29 Professional confidentiality, keeping confidential the data about the health status of the healthcare user from unauthorized access;</p> <p>1.30 Emergency, immediate change occurring in the health status, which in a situation of lack of an urgent healthcare, poses a risk of death or of serious permanent damage to the health of the citizen and resident;</p> <p>1.31 State of emergency: any unexpected situation that endangers the life, integrity and health of the citizens and residents or disrupts functioning of the healthcare institutions to the level that brings to the serious disproportion between the needs for the healthcare and resources available;</p> <p>1.32 Artificial sterilization: medical procedure having as an aim the loss of ability for childbirth;</p>	<p>kojima ima pristup zdravstveni radnik tokom pružanja zdravstvenih usluga;</p> <p>1.29 Profesionalna tajna, podrazumeva čuvanje podataka o zdravstvenom stanju korisnika zdravstvenih usluga od pristupa neovlašćenih lica;</p> <p>1.30 Hitnost, podrazumeva momentalnu promenu zdravstvenog stanja, koja u slučaju nedostatka brze zdravstvene usluge ugrožava život ili ozbiljno oštećenje zdravlja;</p> <p>1.31 Vanredna situacija, je svaka vrsta neočekivanog događaja koji ugrožava život, fizički integritet ili zdravlje građana ili funkcionisanje zdravstvene institucije, koji se ocenjuje da nije u skladu sa potrebom za zdravstvenom zaštitom i raspoloživim mogućnostima;</p> <p>1.32 Veštačka sterilizacija je medicinski postupak koji ima za cilj gubitak sposobnosti osemenjavanja;</p>
--	---	--

<p>1.33 Transplante, janë organet, qelizat dhe indet me origjinë njerëzore ose shtazore të destinuar për tu transferuar te njeriu;</p> <p>1.34 Transplantimi, nënkupton çvendosjen e transplantit brenda të njëjtit individ, midis individëve të të njëjtës specie, midis individëve të specieve të ndryshme, dhe midis individëve identik nga pikëpamja gjenetik, që zbatohet vetëm për nevoja mjekësore dhe kur vlerësohet se kjo është e domosdoshme për të siguruar jetën dhe shëndetin e marrësit të transplantit;</p> <p>1.35 Frytnimi i asistuar, është proces nëpërmjet të cilit qelizat vezë fekondohen me spermatozoid jashtë trupit, <i>in vitro</i>;</p> <p>1.36 Trajtimi para-mjekësor dhe alternativ, nënkupton metodat e trajtimit që janë të regjistruara nga shoqatat profesionale; dhe që duke qenë se nuk janë në pajtim me doktrinën aktuale mjekësore nuk përfshihen në shërbimet zyrtare shëndetësore;</p> <p>2 Në këtë ligj, përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe: njëjësi përfshin shumësin dhe shumësi</p>	<p>1.33 Transplant, the organs, tissues, and cells of human or animal origin destined to be transferred in a human;</p> <p>1.34 Transplantation, removal of the transplant within the same body; from one body to another within same or different species; and from one to another genetically identical bodies, only for medical needs and when is considered necessary to save the life and health of the receiver of the transplant;</p> <p>1.35 Assisted fertilization, a process through which the ovary is fertilized with a spermatozoid outside the body, <i>in vitro</i>;</p> <p>1.36 Para-medical and alternative treatment, the treatment methods verified by professional health associations which are not in compliance with the current medical doctrine and due to that are not part of the official healthcare services.</p> <p>2. In this law, except for the cases when the context implies differently: singular includes plural and plural includes</p>	<p>1.33 Transplanti su organi, ćelije i tkiva ljudskog ili životinskog porekla namenjenih za prenos kod ćoveka;</p> <p>1.34 Transplantiranje, podrazumeva premeštanje transplantata unutar jedne osobe, između istih ili razlićitih vrsti, i između identićnih osoba sa genetskog aspekta, koje se sprovodi samo za medicinske potrebe i kada se oceni da je to neophodno kako bi se osigurao život i zdravlje primaoca transplantata;</p> <p>1.35 Asistirana oplodnja je proces kojim se jajašće i spermatozoidi spajaju izvan organizma, <i>in vitro</i>;</p> <p>1.36 Paramedicinsko i alternativno lećenje, podrazumeva metode lećenja koja su registrovana od strane profesionalnih udruženja, a koja s'obzirom da nisu u skladu sa važećom medicinskom doktrinom nisu deo zvanićnih zdravstvenih usluga.</p> <p>2. U ovom zakonu , osim ukoliko kontekst zahteva drugaćije: jednina podrazumeva množinu a množina jedninu; i "on"</p>
--	---	--

<p>njëjësin; dhe “ai” përfshin “ajo” dhe “tij” përfshin “saj”.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Të drejtat dhe përgjegjësitë në kujdesin shëndetësor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjitetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare, që garantohen me Kushtetutë, dhe zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës. 2. Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor. 3. Secili qytetar dhe banor është i obliguar të përkujdeset për shëndetin e tij. 4. Qytetarët dhe banorët, në mënyrë të organizuar, nëpërmjet shoqatave ose individëve të emëruar, marrin pjesë aktive në krijimin e kushteve më të favorshme për zbatimin e veprimtarisë shëndetësore dhe realizimin e të drejtave të tyre në kuadër të kësaj veprimtarie. 5. Të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve, banorëve, dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve 	<p>singular; and “he” includes “she” and “his” includes “her”.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Rights and responsibilities in healthcare</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Implementation of this law shall be in full compliance with the human dignity, fundamental rights and freedoms set by the Constitution of the Republic of Kosovo, international covenants and legislation guaranteed by the Constitution and directly implemented in the Republic of Kosovo. 2. All the citizens and residents have the right to equal access in healthcare. 3. Every citizen and resident is obliged to take care of his health. 4. The citizens and residents, take active part in creating favorable conditions for implementation of healthcare activities and realizing their rights within this activity, in an organized manner, through associations or appointed individuals. 5. The rights and responsibilities of the citizens, residents, and other healthcare users are regulated by the Law on rights 	<p>podrazumeva "ona" i "njegov" podrazumeva "njen".</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Prava i odgovornosti u zdravstvenoj zaštiti</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Sprovođenje ovog zakona izvršiće se ispoštujući dostojanstvo, osnovna ljudska prava i slobode utvrđenim Ustavom Republike Kosova, sporazimima i međunarodnim instrumentima, koje se garantuju Ustavom, i neposredno se sprovode u Republici Kosova. 2. Svi građani i stanovnici Kosova moraju imati jednak i nediskriminatoran pristup sistemu zdravstvene zaštite. 3. Svaki građanin i stanovnik je obavezan da se stara o njegovom zdravlju. 4. Građani, na organizovan način, preko društava ili imenovanih pojedinaca, aktivno učestvuju u stvaranju najpovoljnijih uslova za sprovođenje zdravstvene delatnosti i njihovo neposredno realizovanje u okviru ove delatnosti. 5. Prava i odgovornosti građana, stanovnika, kao i drugih korisnika zdravstvene zaštite su regulisana Zakonom o pravima i
---	--	--

<p>shëndetësore në kujdesin shëndetësor rregullohen me Ligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.</p> <p style="text-align: center;">Kreu II KUJDESI SHËNDETËSOR</p> <p style="text-align: center;">Neni 5 Parimet e kujdesit shëndetësor</p> <p>1. Kujdesi shëndetësor zbatohet duke u udhëhequr nga parimet themelore, si vijon:</p> <p>1.1 Barazia</p> <p>1.1.1 sigurimi i qasjes së plotë ndaj shërbimeve në Listën e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, pas përcaktimit të saj; për të gjithë qytetarët dhe banorët, përfshirë qasjen e lehtë deri te institucionet shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara;</p> <p>1.1.2 shpërndarja e drejtë e burimeve publike për kujdesin shëndetësor duke pasur dallimet socio-ekonomike;</p> <p>1.1.3 barazia e plotë e sektorit publik, privat, dhe partneritetit publik-privat</p>	<p>and responsibilities of citizens in healthcare.</p> <p style="text-align: center;">Chapter II HEALTHCARE</p> <p style="text-align: center;">Article 5 The principles of implementation in healthcare</p> <p>1. The provision of healthcare is based on the following principles:</p> <p>1.1. Equity</p> <p>1.1.1 assuring all citizens' and residents full access to services in the List of healthcare services after it has been defined; including easy access to the healthcare facilities for the persons with disability;</p> <p>1.1.2 equitable distribution of public resources for health, taking into account socioeconomic difference;</p> <p>1.1.3 Equity between the public sector, private sector, and public-private partnership in</p>	<p>odgovornostima građana u zdravstvenoj zaštiti.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje II ZDRAVSTVENA ZAŠTITA</p> <p style="text-align: center;">Član 5 Načela zdravstvene zaštite</p> <p>1. Zdravstvena zaštita se sprovodi rukovodeći se sledećim osnovnim principima:</p> <p>1.1. Jednakost</p> <p>1.1.1 Obezbeđuje potpun pristup uslugama na Listi osnovnih zdravstvenih usluga ,nakon njihovog utvrđivanja; za sve građane i stanovnike uključujući i lak pristup zdravstvenim ustanovama za osobe sa ograničenim sposobnostima;</p> <p>1.1.2 ravnopravno raspoređivanje javnih resursa za zdravstvenu zaštitu uzimajući u obzir socioekonomske razlike;</p> <p>1.1.3 potpuna ravnopravnost javnog, privatnog i partnerskog javno-privatnog sektora u skladu sa</p>
---	---	---

<p>gjatë ofrimit të kujdesit shëndetësor, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>1.2 Gjithë-përfshirja dhe jo diskriminimi: standarde të barabarta në kujdesin shëndetësor për të gjithë qytetarët dhe banorët duke siguruar standardet gjatë përmbushjes së kërkesave në të gjitha nivelet e kujdesit shëndetësor, si dhe sigurim i kujdesit shëndetësor pa diskriminim në bazë të gjinisë, kombit, racës, ngjyrës, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes sociale, orientimit seksual, shkallës së aftësive fizike dhe mendore, statusit familjar dhe moshës.</p> <p>1.3 Cilësia: aplikimi i standardeve ndërkombëtare në organizimin, zhvillimin, dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor përkitazi me të gjitha aspektet, përfshirë: trajtimin e fokusuar në pacientë, përdorimin e resurseve, organizimin e punës, trajnimin, edukimin, licencimin, akreditimin, udhëzimet etike, dhe mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore.</p>	<p>compliance with this law.</p> <p>1.2 Inclusiveness and non-discrimination: equal healthcare for all citizens and residents by ensuring the standards during fulfilling the needs at all levels of healthcare as well as ensuring healthcare without discrimination on basis of: gender, nation, race, color, language, religion, political preferences, social status, sexual orientation, the level of physical or mental abilities, family status, or age.</p> <p>1.3 Quality: Applying international standards in organization, development and provision of healthcare with respect to all aspects including: patient focused treatment, resources use, organization of: work, training, education, licensing, accreditation, ethical guidelines, and protection of interests of users of healthcare services.</p>	<p>ovim zakonom.</p> <p>1.2.Sveobuhvatnost i nediskriminacija: Jednake zdravstvene standarde za sve građane i stanovnike obezbeđujući standarde tokom ispunjavanja zahteva na svim nivoima zdravstvene zaštite, kao i obezbeđivanje zdravstvene zaštite bez diskriminacije u vezi sa polom, nacijom, rasom, bojom kože, jezikom, verom, političkim uverenjima, socijalnim statusom, imovinskim stanjem, stepenom fizičkih i mentalnih sposobnosti, porodičnim statusom i starošću.</p> <p>1.3.Kvalitet: primena međunarodnih standarda u procesu organizacije i razvoja i ponude zdravstvene zaštite, u vezi sa svim aspektima uključujući: fokusiranu obuku na pacijente, korišćenje resursa, organizaciju rada, edukaciju, licenciranje, akreditaciju, etičke smernice i zaštitu interesa korisnika zdravstvenih usluga</p>
--	---	---

<p>1.4 Ndershmëria dhe llogaridhënia; 1.5 Dhënia e prioritetit intervenimeve kost-efektive të kujdesit shëndetësor, të bazuara në të dhëna; 1.6 Qëndrueshmëria dhe Vazhdueshmëria; 1.7 Parandalimi dhe zbulimi i hershëm i sëmundjeve nëpërmjet promovimit shëndetësor, detektimit, dhe politikave publike shumë-sektoriale për përmirësimin e shëndetit; 1.8 Bashkë-përgjegjësia dhe Solidariteti.</p>	<p>1.4 Honesty and Accountability; 1.5 Prioritization of evidence-based, cost-effective interventions in health care; 1.6 Sustainability and Continuity; 1.7 Prevention and early detection of illnesses through health promotion and multi-sectoral public policies and screening to improve health. 1.8 Co-responsibility and Solidarity,</p>	<p>1.4.Poštenje i odgovornost; 1.5. Davanje prioriteta efektivnim troškovima intervencija u zdravstvu, zasnovanih na podacima; 1.6.Postojanost i kontinuitet; 1.7.Prevenција i rano otkrivanje bolesti preko promocije zdravlja i multisektoriјalnih javnih politika za poboljšanje zdravlja. 1.8.Zajednička odgovornost i solidarnost.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Masat e kujdesit shëndetësor</p> <p>Institucionet e Republikës së Kosovës; institucionet shëndetësore; personat juridik dhe fizik, në pajtim me të drejtat dhe detyrimet e tyre, obligohen që të marrin masat e nevojshme për zbatimin e parimeve dhe masave të kujdesit shëndetësor, nëpajtim me politikat dhe prioritetet e përcaktuara nga Ministria.</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 Healthcare measures</p> <p>Institutions of the Republic of Kosovo; healthcare institutions; legal and natural persons, within their rights and obligations shall take necessary measures to ensure and implement the healthcare principles and healthcare measures, according to policies and priorities established by the Ministry.</p>	<p style="text-align: center;">Član 6 Mere zdravstvene zaštite</p> <p>Institucije Republike Kosova, pravna i fizička lica i zdravstvene ustanove u skladu sa njihovim pravima i obavezama dužni su da preduzimaju potrebne mere za obezbeđivanje i sprovođenje principa zdravstvene zaštite,u skladu sa politikama i određenim prioritetima Ministarstva.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Mbikëqyrja e veprimtarisë shëndetësore</p> <p>Shërbimet dhe veprimtaria e kujdesit shëndetësor i nënshtrohet mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë që e siguron Ministria dhe mbikëqyrjes profesionale që e</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Supervision of healthcare activity</p> <p>Healthcare services and activities are subject to legal supervision ensured by the Ministry and professional supervision ensured by the Chambers of Health Professionals from</p>	<p style="text-align: center;">Član 7 Nadzor zdravstvene delatnosti</p> <p>Usluge i delatnost zdravstvene zaštite podvrgavaju se zakonskom nadzoru koje obezbeđuje Ministarstvo i profesionalnom nadzoru koje obzbeđuje Komora zdravstvenih</p>

siguron Oda e profesionistëve shëndetësor nga neni 71 i këtij Ligji.

**Kreu III
POLITIKAT ZHVILLIMORE NË
SHËNDETËSI**

Neni 8

Politikat për kujdesin shëndetësor

1. Ministria, përpilon politika dhe zbaton ligjet e një sistemi jo-diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore.
2. Ministria, vendos normative dhe standarde dhe nxjerr udhëzime për sektorin e shëndetësisë, duke i respektuar standardet e përkatëse ndërkombëtare.
3. Ministria, ndërmerr të gjitha masat e përcaktuara me ligj për realizimin e veprimeve të duhura me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, banorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor.

Neni 9

Udhëheqja dhe Roli Rregullator

1. Funkcionet udhëheqëse dhe rregullatore të Ministrisë përfshijnë:

article 71 of this law.

**Chapter III
DEVELOPMENT POLICIES IN
HEALTH**

Article 8

Healthcare policies

1. The Ministry develops policies and implements laws of a non-discriminatory and responsible healthcare system based on professional analysis and the scientific data.
2. The Ministry shall establish normatives and standards and develop regulations for the health sector, respecting relevant international standards;
3. The Ministry undertakes all measures defined by law for the implementation of necessary actions to ensure and protect the rights of citizens, residents, and other healthcare users, in healthcare.

Article 9

Stewardship and Regulatory Functions

1. Stewardship and regulatory functions of the Ministry include:

stručnjaka iz člana 71 ovog zakona.

**Poglavlje III
RAZVOJNE POLITIKE U ZDRAVSTVU**

Član 8

Razvojne politike zdravstvene zaštite

1. Ministarstvo, izrađuje politike i sprovodi zakone jednog nediskriminiranog i odgovornog sistema za zdravstvenu zaštitu, baziranog na profesionalnim analizama i naučnim podacima.
2. Ministarstvo, postavlja normative i standarde i donosi uputstva za sektor zdravstva, ispoštujući relevantne međunarodne standarde
3. Ministarstvo preduzima sve mere propisane zakonom za sprovođenje potrebnih aktivnosti za sprovođenje i zaštitu prava građana, stanovnika i drugih korisnika zdravstvenih usluga u zdravstvenoj zaštiti.

Član 9

Rukovođenje i regulatorna uloga

1. Rukovodeće i regulatorne funkcije Ministarstva obuhvataju:

<p>1.1 Zhvillimin dhe zbatimin e politikave dhe ligjeve që sigurojnë sistem jo diskriminator dhe të përgjegjshëm të kujdesit shëndetësor;</p> <p>1.2 koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin dhe zbatimin koherent të politikave shëndetësore;</p> <p>1.3 vendosjen e normave dhe standardeve si dhe nxjerrjen e akteve nën-ligjore për sektorin e shëndetësisë duke i respektuar standardet përkatëse ndërkombëtare;</p> <p>1.4 mbikëqyrjen e zbatimit të standardeve nga pika 3, paragrafi 1 i këtij neni, përfshirë edhe inspektimin dhe shërbimet e tjera, sipas nevojës;</p> <p>1.5 përcjelljen e situatës dhe zbatimin e masave adekuate për parandalimin, identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve në sektorin e shëndetësisë;</p> <p>1.6 menaxhimin dhe zhvillimin e infrastrukturës së kujdesit shëndetësor;</p> <p>1.7 përkrahjen e pjesëmarrjes, iniciativave dhe zhvillimit të aktiviteteve të qytetarëve dhe të</p>	<p>1.1. Developing and guiding implementation of policies and legislation for a non-discriminatory and accountable healthcare system;</p> <p>1.2. Coordinate activities to promote coherent development and implementation of healthcare policies;</p> <p>1.3. Set up norms and standards and issue administrative instructions for the health sector with due regard to relevant international standards;</p> <p>1.4. Supervise implementation of standards from paragraph 1, point 3 of this article, including inspections and other services, as needed;</p> <p>1.5. Monitor the situation and implement appropriate measures to prevent, identify and solve problems in the health sector;</p> <p>1.6. Manage and develop the infrastructure related to healthcare;</p> <p>1.7. Promote participation, initiatives and the development of citizens' and residents activities related to</p>	<p>1.1. Razvoj i sprovođenje nediskriminatorских i odgovornih politika i zakona u sistemu zdravstvene zaštite;</p> <p>1.2. koordinaciju aktivnosti u zdravstvenom sektoru kako bi se promovisao koherentni razvoj zdravstvene politike;</p> <p>1.3. uspostavljanje normativa i standarda, kao i donošenje podzakonskih akata za zdravstveni sektor, uz poštovanje relevantnih međunarodnih standarda;</p> <p>1.4. nadgledanje sprovođenja ovih standarda iz tačke 3, stava 1 ovog člana, uključujući i inspekciju i druge usluge, prema potrebi;</p> <p>1.5. praćenje situacije i primenu odgovarajućih mera za sprečavanje, otkrivanje i rešavanje problema u oblasti zdravstva;</p> <p>1.6. rukovođenje i razvoj infrastrukture za zdravstvenu zaštitu;</p> <p>1.7. podršku učešću, inicijativama i razvoju aktivnosti građana i stanovnika u vezi sa zdravstvom;</p>
--	--	---

<p>banorëve që ndërlidhen me shëndetin;</p> <p>1.8 zhvillimin dhe pjesëmarrjen në fushatat për informim publik dhe projektet e tjera të promovimit shëndetësor me qëllim të rritjes së shkallës së vetëdijes publike dhe pajtueshmërisë me standardet shëndetësore;</p> <p>1.9 përkrahjen e zhvillimit të arsimimit dhe edukimit shëndetësor me qëllim të ngritjes së njohurive dhe kompetencave në lëmin e shëndetësisë;</p> <p>1.10 mbikëqyrjen e kontrollit të cilësisë së ujit dhe ushqimit me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve, në bashkëpunim me ministritë përkatëse, në pajtim me ligjin;</p> <p>1.11 planifikimin e resurseve njerëzore në shëndetësi;</p> <p>1.12 Ministria mund të formojë komisione, komitete, borde, këshilla profesionale dhe trupa të tjerë profesional për çështje dhe lëmi të caktuara, në pajtim me këtë ligj dhe aktet përcjellëse nën-ligjore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Politikat Zhvillimore në Shëndetësi</p> <p>1. Zbatimi i politikave zhvillimore në</p>	<p>health;</p> <p>1.8. Development and participation in the campaigns on public information and other healthcare promotion projects to increase public awareness and compliance with health standards;</p> <p>1.9. Encouraging development of health education in order to raise knowledge and competencies in the health field;</p> <p>1.10. Supervision of the water and food quality control services in order to protect consumers, in coordination with the competent ministries, in compliance with the law.</p> <p>1.11. Planning of human resources in the health sector;</p> <p>1.12. The Ministry, where appropriate, shall establish commissions, committees, boards and professional counsels for certain fields and issues, in compliance with the law. and relevant sub-legal acts.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Health Care Development Policies</p> <p>1. Implementation of the healthcare</p>	<p>1.8. učešće u kampanjama javnog informisanja i drugim projektima zdravstvenog unapređenja, u cilju povećanja stepena svesti javnosti i pridržavanja zdravstvenih standarda;</p> <p>1.9. podrška razvoju zdravstvenog obrazovanja u cilju povećanja znanja i sposobnosti iz oblasti zdravstva;</p> <p>1.10. nadzor nad uslugama kontrole kvaliteta vode i hrane, u cilju zaštite potrošača u saradnji sa relevantnim ministarstvima, u skladu sa zakonom.</p> <p>1.11. planiranje ljudskih resursa u zdravstvu;</p> <p>1.12. Ministarstvo prema potrebi može da formira komisije, komitete, odbore, stručne savete i druga stručna tela za određene teme i oblasti, u skladu sa ovim Zakonom i pratećim podzakonskim aktima.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Sprovođenje razvojnih politika</p> <p>1. Sprovođenje razvojnih politika u zdravstvu</p>
---	---	---

<p>shëndetësi është përgjegjësi e Ministrisë e cila nëpërmjet planeve sektoriale, organizimit, financimit, standardeve, rregullimit, dhe menaxhimit siguron mbështetje për përmirësimin e shëndetit duke udhëzuar sjelljen e institucioneve të tjera qeveritare, komunale, të punësuarve, të punëdhënësve, të shoqërisë civile, të qytetarëve, të banorëve, dhe të sistemit të kujdesit shëndetësor.</p> <p>2. Politikat zhvillimore në shëndetësi definojnë nëpërmjet planeve:</p> <p>2.1 strategjike;</p> <p>2.2 afat-mesme;</p> <p>2.3 operative.</p> <p>3. Planet strategjike, afatmesme, dhe operative përpilohen në bazë të kriterëve dhe për cikle kohore të përcaktuara nga Qeveria.</p> <p>4. Planin strategjik e miraton Kuvendi i Kosovës.</p> <p>5. Planin afatmesëm të zhvillimit të kujdesit shëndetësor e miraton Qeveria.</p> <p>6. Planin operativ të zhvillimit të kujdesit parësor shëndetësor, e miraton Ministria në propozim të Kuvendit të komunës, në pajtim me planin afat-mesëm të miratuar nga Qeveria.</p>	<p>development policies is responsibility of the Ministry which via sectoral plans, organization, financing, standards, regulation and management shall provide incentive for the improvement of the health by guiding the behavior of other government institutions, municipalities, employees, employers, civic society, citizens, residents, and the health care system.</p> <p>2. The healthcare development policy shall be defined through:</p> <p>2.1. Strategic plans;</p> <p>2.2. Mid-term plans;</p> <p>2.3. Operational plans.</p> <p>3. Strategic, mid-term, and operational plans shall be elaborated based on the criteria and the planning cycles established by the Government.</p> <p>4. The strategic plan is approved by the Assembly of Kosovo.</p> <p>5. The mid-term healthcare development plan is approved by the Government.</p> <p>6. The Ministry on the proposal of the Municipal Assembly approves the operational plan for the development of primary healthcare, in compliance with the mid-term plan approved by the Government.</p>	<p>je odgovornost Ministarstva, koje preko sektorijalnih planova organizacije, finansiranja, standarda, uređenja i menadžiranja obezbeđuje podršku poboljšanju zdravlja i utiče na ponašanje dugih vladinih institucija, opštinskih institucija, zaposlenih, poslodavaca, civilnog društva, građana, stanovnika i zdravstvenog sistema zaštite.</p> <p>2. Sprovođenje razvojnih politika u zdravstvu obezbeđuje se putem:</p> <p>2.1 Strateških planova;</p> <p>2.2 Srednjoročnih planova,</p> <p>2.3 Operativnih planova.</p> <p>3. Strateški, srednjoročni, i operativni planovi se izrađuju na osnovu kriterija i rokova planiranja, određenih od strane Vlade.</p> <p>4. Strateški plan usvaja Skupština Kosova.</p> <p>5. Srednjoročni plan razvoja zdravstvene zaštite usvaja Vlada.</p> <p>6. Operativni plan razvoja primarne zdravstvene zaštite, usvaja Ministarstvo na predlog Skupštine opštine, u skladu sa srednjoročnim planom odobrenim od strane Vlade.</p>
--	--	--

<p>7. Planin operativ të zhvillimit të kujdesit dytësor dhe tretësor shëndetësor e miraton Qeveria.</p> <p>8. Procedurat e detajizuara rreth përgatitjes së planeve: strategjike, afat-mesme dhe operative për të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor përcaktohen me aktin nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.</p>	<p>7. The Government approves the operational plan for development of the secondary and tertiary healthcare.</p> <p>8. The detailed procedures regarding preparation of strategic, mid-term and operational plans for all healthcare levels shall be determined by a sub-legal act issued by the Ministry.</p>	<p>7. Operativni plan razvoja sekundarne i tercijalne zdravstvene zaštite usvaja Vlada.</p> <p>8. Detaljne postupke u vezi sa pripremom strateških, srednjoročnih i operativnih planova za sve nivoe zdravstvenog sistema određuje Ministarstvo pod-zakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;">Kreu IV ZBATIMI I KUJDESIT SHËNDETËSOR</p>	<p style="text-align: center;">Chapter IV HEALTHCARE IMPLEMENTATION</p>	<p style="text-align: center;">Poglavlje IV SPROVOĐENJE ZDRAVSTVENE ZAŠTITE</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Shërbimet</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Services</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Usluge</p>
<p>përbërë nga dy gjinekolog-obstetër dhe një psikiatër.</p> <p>4. Ndërprerja e shtatzënisë rregullohet me ligj të veçantë.</p>	<p>three medical specialists: two gynecologists-obstetricians and one psychiatrist.</p> <p>4. Termination of pregnancy is regulated by a special law.</p>	<p>psihijatra.</p> <p>4. Prekid trudnoće uređuje se posebnim zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 79 Sterilizimi Artificial</p> <p>1. Sterilizimi artificial mund të kryhet me kërkesën individuale të dy gjinive pas konsultimit mjekësor.</p> <p>2. Sterilizimi artificial mund, poashtu, të kryhet, edhe në rastet kur është i kërcënuar shëndeti i pacientit, në bazë të rekomandimit të mjekut specialistë dhe pëlqimit me shkrim të pacientit.</p> <p>3. Në rastet kur pëlqimi me shkrim i qytetarit nga paragrafi 2 i këtij neni nuk mund të sigurohet, zbatohen dispozitat e neni 4 paragrafi 5 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësor.</p>	<p style="text-align: center;">Article 79 Artificial sterilization</p> <p>1. Artificial sterilization can be carried out at the individual request of both genders after medical consultation.</p> <p>2. Artificial sterilization can also be carried out in cases where the patient's health is endangered according to the recommendation of a specialist doctor and with the written consent of the patient.</p> <p>3. If a the written consent from paragraph 2 of this section cannot be provided, provisions of the Law on the rights and responsibilities of the citizens in healthcare from article 4 paragraph 5 of this law, shall be applied.</p>	<p style="text-align: center;">Član 79 Veštačka sterilizacija</p> <p>1. Veštačka sterilizacija se može obaviti na lični zahtev osoba oba pola, nakon lekarske konsultacije.</p> <p>2. Veštačka sterilizacija se može obaviti i na osnovu preporuke lekara specijaliste i u slučajevima kada je ugroženo zdravlje pacijenta, uz pismenu saglasnost pacijenta.</p> <p>3. U slučaju kada se ne može obezbediti pismena saglasnost pacijenta iz stava 2 ovog člana,, primenjuju se odredbe iz člana 4 stav 5 Zakona o pravima i odgovornostima građana u zdravstvenoj zaštiti.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 80 Frytnimi i asistuar</p> <p>1. Frytnimi i asistuar është i ndaluar në rastet kur qelizat seksuale të personit përdoren pa dijenin e tij dhe nëse ato përdoren për frytnimin e personit tjetër që nuk është pjesë e çiftit, me ose pa dijeninë e tij.</p> <p>2. Frytnimi i asistuar nuk është i lejuar në rastet kur dhuruesi është anëtarë i</p>	<p style="text-align: center;">Article 80 Assisted Fertilization</p> <p>1. Assisted fertilizing, is prohibited in cases the sexual cells of the person are used without his knowledge and if it is used to fertilize another person than the couple with or without his knowledge;</p> <p>2. Artificial fertilizing is not allowed, in</p>	<p style="text-align: center;">Član 80 Asistirana oplodnja</p> <p>1. Zabranjena je asistirana oplodnja, u slučaju kada se seksualne ćelije osobe odstranjuju bez njegovog znanja i primenjuju za oplodnju druge osobe koja nije deo para, ili bez njegovog znanja;</p> <p>2. Zabranjena je asistirana oplodnja u slučajevima kada je davaoc član uže</p>

<p>familjes së ngushtë të njërit prej pjesëtarëve të çiftit.</p> <p>3. Frytnimi i asistuar rregullohet dhe mbikëqyret me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.</p> <p style="text-align: center;">Kreu XVIII TRANSPLANTIMI I QELIZAVE, INDEVE DHE ORGANEVE</p> <p style="text-align: center;">Neni 81</p> <p>1. Ndalohet çdo lloj reklamimi, tregtimi, dhe trafikimi ilegal që ka të bëjë me transplanto.</p> <p>2. Transplantimi i qelizave, indeve, dhe organeve mund të bëhet vetëm në institucionin shëndetësor të licencuar për këtë qëllim nga Ministria.</p> <p>3. Transplantimi i indeve, organeve dhe qelizave, rregullohet me ligj të veçantë.</p> <p style="text-align: center;">Kreu XIX KUJDESI SHËNDETËSOR GJATË GJENDJEVE EMERGJENTE</p> <p style="text-align: center;">Neni 82 Përgjegjësitë e Ministrisë</p> <p>1. Zbatimi i kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së emergjencës sigurohet nga ana e Ministrisë në pajtim me këtë ligj dhe legjislacionin tjetër në fuqi.</p> <p>2. Aktivitetet e kujdesit shëndetësor në</p>	<p>cases when the donor is a close family member of one of the members of the couple;</p> <p>3. Assisted fertilization is applied according to the provisions of the sub-legal act issued by the Ministry.</p> <p style="text-align: center;">Chapter XVIII CELL, TISSUE, AND ORGAN TRANSPLANTATION</p> <p style="text-align: center;">Article 81</p> <p>1. All advertisement, bargaining, and illegal trafficking related to transplants, are prohibited.</p> <p>2. Cell, tissue and organ transplantation shall be carried out only in a healthcare institution authorized for this purpose by the Ministry.</p> <p>3. Cell, tissue and organ transplantation is regulated by a special law.</p> <p style="text-align: center;">Chapter XIX HEALTHCARE DURING EMERGENCIES</p> <p style="text-align: center;">Article 82 Responsibilities of the Ministry</p> <p>1. During the state of emergency, the provision of healthcare is ensured by the Ministry in compliance with the law and other legislations in power.</p>	<p>porodice jednog od para;</p> <p>3. Potpomognuta oplodnja reguliše se i nadzire podzakonskim aktom donetim od strane Ministarstva.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje XVIII TRANSPLANTACIJA ČELIJA, TKIVA I ORGANA</p> <p style="text-align: center;">Član 81</p> <p>1. Zabranjen je svaki oblik delatnosti koje favorizuje reklamiranje, trgovinu i nelegalnu trgovinu transplantima.</p> <p>2. Transplantacija ćelija, tkiva i organa može da se obavlja samo u zdravstvenoj ustanovi koja je za ovu svrhu ovlašćena od strane Ministarstva.</p> <p>3. Transplantacija ćelija, tkiva i organa uređuje se posebnim zakonom.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje XIX ZDRAVSTVENA ZAŠTITA TOKOM VANREDNOG STANJA</p> <p style="text-align: center;">Član 82 Odgovornosti Ministarstva</p> <p>1. U toku vanrednog stanja, obezbeđivanje zdravstvene zaštite sprovodi se od strane Ministarstva u skladu sa ovim Zakonom i ostalim zakonima na snazi.</p> <p>2. Aktivnosti zdravstvene zaštite u slučaju</p>
---	---	---

<p>rastet e emergjencës nga paragrafi 1 i këtij neni përfshijnë:</p> <p>2.1 zbatimin e dispozitave ligjore në fuqi;</p> <p>2.2 adaptimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në përputhje me planin emergjent;</p> <p>2.3 zbatimin e ndryshimeve në sistemin e referimit dhe të udhëheqjes;</p> <p>2.4 sigurimin e shërbimit emergjent të kujdesit shëndetësor për qytetarët;</p> <p>2.5 veprimin e institucioneve të përkohshme shëndetësore;</p> <p>2.6 aktivizimin e kapaciteteve plotësuese dhe të rezervave.</p> <p>3. Gjatë gjendjeve emergjente të drejtat e qytetarëve të përcaktuara me ligje, do të garantohen deri në masën që nuk e rrezikon efikasitetin e masave të ndërmarra për tejkalimin e tyre.</p> <p>4. Dinjiteti i qytetarit do të respektohet në tërësi dhe vazhdimisht, pavarësisht nga kufizimet që i përcakton paragrafi 3 i këtij neni.</p> <p style="text-align: center;">Neni 83 Përgjegjësitë e Qeverisë</p>	<p>2. Healthcare activities in case of emergencies from paragraph 1 of this article include:</p> <p>2.1. The implementation of legal provisions in force;</p> <p>2.2. Adapting the healthcare system in compliance with the emergent planning;</p> <p>2.3. Implementing changes within referral and management system;</p> <p>2.4. Provision of emergency healthcare for citizens;</p> <p>2.5. Functioning of the provisional healthcare institutions;</p> <p>2.6. Activating supplementary and reserve resources.</p> <p>3. During emergency situations, the citizens' rights defined by the law shall be guaranteed to an extent that will not endanger the efficiency of efforts undertaken to overcome the emergency situation.</p> <p>4. The human dignity shall in general be respected, regardless of the limitations from paragraph 3 of this article.</p> <p style="text-align: center;">Article 83</p>	<p>vanrednog stanja obuhvaćaju:</p> <p>2.1 sprovođenje zakonskih odredbi koje su na snazi;</p> <p>2.2 adaptiranje sistema zdravstvene zaštite u skladu sa urgentnim planom;</p> <p>2.3 sprovođenje izmena u sistemu uputstava i rukovođenja;</p> <p>2.4 obezbeđivanje urgentnih usluga zdravstvene zaštite za građane;</p> <p>2.5 delovanje privremenih zdravstvenih institucija;</p> <p>2.6 aktivizacija dopunskih kapaciteta i rezervi.</p> <p>3. U toku vanrednog stanja, prava građana određena zakonima ,garantovana su do mere koja ne ugrožava efikasnost mera koje se preduzimaju za prevazilaženje vanrednog stanja.</p> <p>4. Dostojanstvo građana se mora poštovati u potpunosti i dosledno, bez obzira na ograničenja koja su definisana u stavu 3 ovog člana.</p> <p style="text-align: center;">Član 83 Odgovornosti Vlade</p>
---	---	--

<p>1. Qeveria, organizon, përgatit, dhe financon aktivitetet për realizimin e kujdesit shëndetësor në rrethana të gjendjes së jashtëzakonshme.</p> <p>2. Aktivitetet përgatitore të Qeverisë për sigurimin e kujdesit shëndetësor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme përfshijnë:</p> <p>2.1 sigurimin e aktiviteteve planifikuese;</p> <p>2.2 përcaktimin e strukturave të udhëheqjes;</p> <p>2.3 përcaktimin e detyrimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve sektoriale dhe komunale;</p> <p>2.4 zhvillimin e rregullativës ligjore dhe administrative;</p> <p>2.5 sigurimin e stoqeve të medikamenteve dhe të materialit shpenzues medicinal;</p> <p>2.6 ripërtirjen e rezervave shtetërore për shëndetësi, deri në masën e nevojshme;</p> <p>2.7 sigurimin e trajnimeve për shërbimet e kujdesit shëndetësor përkitazi me gjendjet e jashtëzakonshme.</p> <p style="text-align: center;">Neni 84 Përgjegjësitë e institucioneve shëndetësore</p> <p>1. Institucionet shëndetësore obligohen</p>	<p style="text-align: center;">Responsibilities of the Government</p> <p>1. The Government organizes, prepares and finances activities for implementation of healthcare activities during emergencies.</p> <p>2. Preparatory activities of the Government for healthcare provision in emergencies include:</p> <p>2.1. Provision of planning activities;</p> <p>2.2. Determining managerial structures;</p> <p>2.3. Determining the obligation for cooperation between sector and municipal authorities;</p> <p>2.4. Development of legal and administrative regulations;</p> <p>2.5. Ensuring stocks of drugs and medicinal expendables;</p> <p>2.6. Renewal of the state healthcare reserves to the level necessary;</p> <p>2.7. Ensuring training for implementation of the healthcare in states of emergency.</p> <p style="text-align: center;">Article 84 Responsibilities of healthcare institutions</p>	<p>1. Vlada organizuje, priprema i financiranje aktivnosti za realizaciju zdravstvene zaštite u okolnostima vanrednog stanja.</p> <p>2. Pripremne aktivnosti Vlade za obezbeđivanje zdravstvene zaštite u slučaju vanrednog stanja obuhvataju:</p> <p>2.1 obezbeđivanje planskih aktivnosti;</p> <p>2.2 određivanje rukovodećih struktura;</p> <p>2.3 definisanje obaveze saradnje između opštinskih i sektorijalnih autoriteta.</p> <p>2.4 razvoj zakonske i administrativne regulative;</p> <p>2.5 obezbeđivanje zaliha lekova i potrošnog medicinskog materijala;</p> <p>2.6 obnavljanje državne rezervi za zdravstvo, do potrebne mere;</p> <p>2.7 obezbeđivanje obuka za usluge zdravstvene zaštite u vanrednim stanjima.</p> <p style="text-align: center;">Član 84 Odgovornosti zdravstvenih institucija</p> <p>1. Zdravstvene ustanove su dužne da</p>
--	--	--

<p>të zhvillojnë plane për situatat e gjendjeve të jashtëzakonshme.</p> <p>2. Kushtet formale për planet nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktohen me akt nën-ligjor të nxjerrë nga Ministria.</p> <p style="text-align: center;">Kreu XX DISPOZITAT QË RREGULLOJNË MARRËDHËNIET NDËRKOMBËTARE</p> <p style="text-align: center;">Neni 85</p> <p>1. Sigurimi i kujdesit shëndetësor për qytetarët që nuk janë banorë të Republikës së Kosovës, si dhe kompensimi i çmimit të shërbimeve të shfrytëzuara bëhet në bazë të: legjislacionit në fuqi, marrëveshjes bilaterale ndërshtetërore, marrëveshjes ndërkombëtare, ose në bazë të parimit të reciprocitetit, duke u bazuar në Rregulloren e BE 883/04 dhe 987/09.</p> <p>2. Në mungesë të kushteve ligjore nga paragrafi 1 i këtij neni, shtetasit e huaj janë të obliguar të shfrytëzojnë kujdesin shëndetësor në Republikën e Kosovës, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>3. Shtetasit e huaj i kanë në dispozicion shërbimet e kujdesit emergjent shëndetësor nën kushte të njëjta si edhe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.</p>	<p>1. Healthcare institutions are obliged to develop plans for states of emergency.</p> <p>2. The formal conditions for such plans from paragraph 1 of this article shall be defined in the sub-legal act issued by the Ministry.</p> <p style="text-align: center;">Chapter XXI PROVISIONS REGULATING INTERNATIONAL RELATIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 85</p> <p>1. Healthcare provision in the public healthcare institutions to non-Kosovar citizens residing in Kosovo, as well as compensation for provided services shall be made on the grounds of: legislation in power, interstate agreements, international agreements, or based on the principle of reciprocity, following EU Regulations 883/04 and 987/09.</p> <p>2. In the absence of legal conditions from paragraph 1 of this article, foreign citizens are obliged to healthcare in the territory of the Republic of Kosovo, based on the provisions of this law.</p> <p>3. For foreign citizens that seek emergency healthcare, this care should be provided under the same conditions as for the citizens of the Republic of</p>	<p>razvijaju planove za situacije vanrednog stanja.</p> <p>2. Formalne uslove za planove iz stava 1 ovog člana određuju podzakonski akti, donetim od strane Ministarstva.</p> <p style="text-align: center;">Poglavlje XX ODREDBE KOJE REGULIŠU MEĐUNARODNE ODOSE</p> <p style="text-align: center;">Član 85</p> <p>1. Obezbeđivanje zdravstvene zaštite za građane koji nisu stanovnici Republike Kosova, kao i naknada za cenu korišćenih usluga vrši na osnovu: zakona na snazi, bilateralnih međudržavnih sporazuma, međunarodnog sporazuma, ili na osnovu principa reciprociteta, saglasno Pravliniku EU 883/04 i 987/09.</p> <p>2. U odsustvu pravnih uslova iz stava 1, strani građani su dužni da koriste zdravstvenu zaštitu u Republici Kosova, u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>3. Strani građani imaju na raspolaganju urgentne usluge zdravstvene zaštite pod istim uslovima kao i državljani Republike Kosova.</p>
---	---	--

<p>4. Shkakut dhe rrethanat e vdekjes së shtetasit të huaj duhet të konstatohen, në pajtim me këtë ligj.</p> <p>5. Në rastin e vdekjes së shtetasit të huaj duhet që menjëherë të njoftohen organet kompetente ndërkombëtare.</p> <p>6. Pjesëmarrja në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor ose në forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar në lëmin e shëndetësisë, në rast të gjendjes së jashtëzakonshme jashtë territorit të Republikës së Kosovës realizohet në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare ose në bazë të parimit të reciprocitetit.</p>	<p>Kosovo.</p> <p>4. The cause and circumstances of the death of non-Kosovo citizens should be ascertained, in compliance with this law.</p> <p>5. In the case of death of a foreign citizen, the competent international bodies should be notified immediately.</p> <p>6. Participation in healthcare service provision or other forms of international cooperation in the health field, in cases of a state of emergency outside the territory of the Republic of Kosovo is realized based on international agreements or based on the principle of reciprocity.</p>	<p>4. Uzroci i okolnosti smrti stranog državljanina se moraju konstatovati, u skladu sa ovim Zakonom.</p> <p>5. O slučaju smrti stranog državljanina moraju se bez odlaganja obavestiti ovlašćeni međunarodni organi.</p> <p>6. Učešće u pružanju usluga zdravstvene zaštite ili drugih oblika međunarodne saradnje u oblasti zdravstva, u slučaju vanrednog stanja van teritorije Republike Kosova, realizuje se na osnovu međunarodnog sporazuma ili na osnovu principa reciprociteta.</p>
<p style="text-align: center;">Kreu XXI DISPOZITAT DISIPLINORE DHE GJYQËSORE</p>	<p style="text-align: center;">Chapter XXI DISCIPLINARY AND COURT PROVISIONS</p>	<p style="text-align: center;">Poglavlje XXI DISCIPLINSKE I SUDSKE ODREDBE</p>
<p style="text-align: center;">Neni 86 Vërejtja me shkrim</p>	<p style="text-align: center;">Article 86 Written notice</p>	<p style="text-align: center;">Član 86 Pismena opomena</p>
<p>1. Institucionit shëndetësor do t'i shqiptohet vërejtja me shkrim nga ana e Inspektoratit Shëndetësor, në rastet kur konstatohet:</p> <p>1.1 shkelja e kodit të etikës mjekësore;</p> <p>1.2 shkelja e normave të sigurisë teknike dhe mjekësore;</p> <p>1.3 shkelja e detyrimeve të përcaktuara gjatë grevës;</p>	<p>1. The healthcare institution shall be given a written notice by the Health Inspectorate in cases of:</p> <p>1.1 Essential violation of the code of medical ethics;</p> <p>1.2 Essential violation of norms from technical and medical safety;</p> <p>1.3 Violation of obligations during</p>	<p>1. Zdravstvenoj ustanovi određuje se mera pismene opomene u slučaju konstatacije:</p> <p>1.1 kršenja lekarskog koda etike;</p> <p>1.2 kršenja normi sa aspekta tehničke i lekarske sigurnosti;</p> <p>1.3 kršenja određenih obaveza u toku štrajka;</p>

<p>1.4 lëshimet gjatë mjekimit;</p> <p>1.5 mos-sigurimi i kushteve dhe mos-zbatimi i masave të kujdesit shëndetësor;</p> <p>1.6 marrëdhënie jo-korrekte me qytetarin.</p> <p>2. Institucioni shëndetësor dhe Drejtori i tij që nuk i binden vërejtjes me shkrim i nënshtrohen masave ndëshkimore, të përcaktuara me nenin 87 të këtij Ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 87 Sanksionet për shkelje administrative dhe kundërvajtje</p> <p>1. Institucioni shëndetësor dënohet me gjobë prej 2.000 deri në 8.000€ për shkelje administrative dhe për kundërvajtje, në rastet në vijim:</p> <p>1.1 ushtron veprimtarinë pa përmbushur kushtet nga neni 40;</p> <p>1.2 shkelë dispozitat e nenit 41 paragrafi 4 duke bërë referim jo të ligjshëm të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;</p> <p>1.3 ushtron veprimtarinë pa licencë valide të punës duke shkelë nenin 42 paragrafi 1;</p> <p>1.4 nuk kujdeset për të dhënat shëndetësore të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore në</p>	<p>strikes;</p> <p>1.4 Mistakes during the process of treatment;</p> <p>1.5 Non-compliance with the conditions and non-application of measures of healthcare;</p> <p>1.6 Miss-conduct of citizens.</p> <p>2. The healthcare institution and its director not complying with the written notice are subject to punitive measures defined by article 87 of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 87 Sanctions for Administrative Offenses</p> <p>1. A fine of 2.000 up to 8.000€ shall be the charge of healthcare institution in cases of administrative offences when the institution:</p> <p>1.1 Conducts activities without fulfilling the conditions of article 40;</p> <p>1.2 Violates provisions of article 41, paragraph 4, conducting illegal referral of healthcare user;</p> <p>1.3 Conducts activities against article 42, paragraph 1, without a valid working license;</p> <p>1.4 Does not keep medical records and evidences of the healthcare user in</p>	<p>1.4 propusta tokom lečenja;</p> <p>1.5 neobezbeđivanja uslova za sprovođenje zdravstvene zaštite;</p> <p>1.6 nekorektnom odnosu prema građaninu.</p> <p>2. Zdravstvena institucija i njen direktor koji ne budu poštovali pismenu opomenu biće podvrgnuti ostalim kaznenim merama, prema članu 87 ovog zakona..</p> <p style="text-align: center;">Član 87 Sankcije za administrativne prekršaje</p> <p>1. Kaznom od 2.000€ do 8.000€ kazniće se zdravstvena institucija za administrativni prekršaj i krivični prekršaj u slučajevima kada institucija:</p> <p>1.1 obavlja zdravstvenu delatnost bez ispunjavanja uslova prema članu 40 ovog Zakona;</p> <p>1.2 obavlja zdravstvenu delatnost u suprotnosti sa članom 41 stav 4 ovog Zakona upućujući na ilegalan način korisnika zdravstvenih usluga ;</p> <p>1.3 obavlja zdravstvenu delatnost bez validne licence za rad u suprotnosti sa članom 42 stavom 1;</p> <p>1.4 ne vodi evidencije i medicinsku dokumentaciju korisnika zdravstvenih usluga u skladu sa</p>
---	--	---

<p>pajtim me nenin 52;</p> <p>1.5 nuk siguron qasje në të dhënat sipas nenit 53 paragrafi 1;</p> <p>1.6 nuk siguron konstatimin e vdekjes dhe përcaktimin e shkakut të vdekjes në pajtim me nenin 75 paragrafin 4;</p> <p>1.7 nuk i siguron kushtet për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësor të punësuar nga institucioni, nga neni 68;</p> <p>1.8 nuk siguron kujdesin shëndetësor gjatë grevës, nga neni 73 dhe neni 74;</p> <p>1.9 nuk harmonizon organizimin dhe aktet normative me këtë ligj, sipas nenit 90;</p> <p>1.10 nuk i siguron kushtet për mbikëqyrje ose e pengon organin e autorizuar nga neni 47 i këtij ligji në kryerjen e detyrës së tij, në pajtim me ligjin;</p> <p>1.11 nuk i bindet vërejtjes më shkrim.</p> <p>2. Personi përgjegjës në institucionin shëndetësor dënohet për kundërvajtje me gjobë prej 2.000€ deri në 5.000€ për shkelje të dispozitave nga:</p> <p>2.1 neni 40 dhe neni 42 për ushtrimin e veprimtarisë pa i përmbushur kushtet ligjore të</p>	<p>compliance with article 52;</p> <p>1.5 Fails to ensure access to health data in compliance with article 53, paragraph 1;</p> <p>1.6 Fails to ensure the death conclusion and the cause of death according to Article 75, paragraph 4;</p> <p>1.7 Fails to ensure conditions for continuous professional development of health professionals hired by the institution, in compliance with article 68;</p> <p>1.8 Fails to ensure healthcare during strike, from article 73 and article 74;</p> <p>1.9 Fails to harmonize the organization and normative acts with this law, as defined in Article 90;</p> <p>1.10 Does not provide terms for supervision or prevents the authorized body from article 47, to carry out its duty, in compliance with the law;</p> <p>1.11 Does not commit to the written notice.</p> <p>2. The person in charge of the healthcare institution shall be punished by the fine of 2000 Euros up to 5000 Euros for violation of provisions from:</p> <p>2.1 Article 40 and 42 for conducting activities without fulfilling the</p>	<p>odredbama člana 52;</p> <p>1.5 ne obezbeđuje pristup do zdravstvenih podataka u skladu sa članom 53 stav 1;</p> <p>1.6 ne obezbeđuje postupak konstatacije smrti i konstataciju uzroka smrti prema članu 75 stav 4.;</p> <p>1.7 ne obezbeđuje uslove za stalno stručno usavršavanje zdravstvenih stručnjaka zaposlenih u njoj ,iz člana 68 ;</p> <p>1.8 ne obezbeđuje zdravstvenu zaštitu u toku štrajka prema članu 73 i članu 74;</p> <p>1.9 ne usklađuje organizaciju i normative akte sa ovim Zakonom, prema članu 90;</p> <p>1.10 ne obezbeđuje uslove za nadzor ili sprečava ovlašćeni organ iz člana 47 ovog Zakona u obavljenju dužnosti, u skladu sa zakonom;</p> <p>1.11 ne poštuje pismenu opomenu.</p> <p>2. Zdravstvena ustanova i odgovorno lice kazniće se novčanom kaznom od 2.000 € do 5.000 evra zbog kršenja ovih odredbi:</p> <p>2.1 Članova 40 i 42 za sprovođenje aktivnosti bez ispunjavanja zakonskih uslova određenih ovim zakonom;</p>
---	---	---

<p>përcaktuara me këtë ligj;</p> <p>2.2 neni 41 për parandalimin e konfliktit të interesit;</p> <p>2.3 neni 52 për ruajtjen e të dhënave të shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore;</p> <p>2.4 neni 53 paragrafi 1 për mos sigurimin e qasjes ligjore në të dhënat shëndetësore;</p> <p>2.5 neni 68 për zhvillimin e vazhdueshëm profesional;</p> <p>2.6 neni 73 dhe neni 74 për sigurimin e kujdesit shëndetësor gjatë grevës;</p> <p>2.7 neni 75 paragrafi 4 i për konstatimin e vdekjes;</p> <p>2.8 neni 76 paragrafi 2 për përcaktimin e shkakut të vdekjes me obduksion;</p> <p>2.9 neni 90 për harmonizimin e organizimit dhe akteve normative me këtë ligj.</p> <p>3. Profesionisti shëndetësor dënohet me marrje të licencës së punës në kohëzgjatje prej:</p> <p>3.1 gjashtë (6) muaj kur shkel dispozitat e nenit 41 paragrafi 1 për punën e njëkohshme në institucionin publik dhe privat shëndetësor për referim jo të ligjshëm;</p> <p>3.2 gjashtë (6) muaj kur shkel dispozitat e nenit 41 paragrafi 4</p>	<p>legal conditions set by this law;</p> <p>2.2 Article 41 on prevention of conflict of interest;</p> <p>2.3 Article 52 on protection of data of the healthcare user;</p> <p>2.4 Article 53 paragraph 1, for not ensuring the legal access to health data;</p> <p>2.5 Article 68 on continuous professional development;</p> <p>2.6 Article 73 and article 74 on provision of healthcare during the strike;</p> <p>2.7 Article 75 paragraph 4 on death conclusion;</p> <p>2.8 Article 76 paragraph 2, on death conclusion with abduction;</p> <p>2.9 Article 90 on harmonization of organization and normative acts with this law.</p> <p>3. Health professional shall be punished by revocation of license in a time span of:</p> <p>3.1 Six (6) months upon violation of provisions in article 41 paragraph 1 on simultaneous work in a public and private healthcare institution;</p> <p>3.2 Six (6) months upon violation of</p>	<p>2.2 Člana 41 u vezi sprečavanja konflikta interesa;</p> <p>2.3 Člana 52 u vezi zaštite podataka korisnika zdravstvenih usluga;</p> <p>2.4 Člana 53 zbog sprečavanja zakonskog pristupa do zdravstvenih podataka;</p> <p>2.5 Člana 68 u vezi stalnog stručnog usavršavanja;</p> <p>2.6 Članova 73 i 74 u vezi pružanja zdravstvene zaštite u toku štrajka;</p> <p>2.7 Člana 75 stava 4 u vezi utvrđivanja smrti;</p> <p>2.8 Člana 76 stava 2, u vezi utvrđivanja uzroka smrti obdukcijom;</p> <p>2.9 Člana 90 u vezi usklađivanja i podzakonskih akata sa ovim Zakonom.</p> <p>3. Zdravstveni stručnjak će biti kažnjen oduzimanjem radne dozvole u vremenskom periodu od:</p> <p>3.1 šest (6) meseci kada prekrši odredbe člana 41 stav 1 za istovremeni rad u javnoj i privatnoj zdravstvenoj ustanovi, za nezakonito delovanje;</p> <p>3.2 Šest (6) meseci zbog kršenja člana 41 stav 4 o nezakonitom delovanju;</p>
--	--	---

<p>për referim jo të ligjshëm;</p> <p>3.3 gjashtë (6) muaj kur shkel dispozitat e nenit 51 paragrafi 2 duke mos zbatuar raportimin e të dhënave në pajtim me këtë ligj;</p> <p>3.4 një (1) viti kur shkel dispozitat e nenit 41 paragrafi 5 duke pranuar shpërblim jo të ligjshëm financiar ose tjetër.</p> <p>4. Profesionisti shëndetësor dënohet me gjobë prej 1000 deri në 2.000€ në rastet e kundërvajtjeve, kur:</p> <p>4.1 ndërmerr trajtim pa leje të qytetarit ose të banorit apo të personit të autorizuar nga ai, duke shkelur dispozitat e aktit ligjor nga neni 4 i këtij ligji përveç në rastet emergjente kur vihet në rrezik jeta e tij;</p> <p>4.2 ofron barëra për qytetarët ose banorët pa recetë në kundërshtim me nenin 26 paragrafin 2 të këtij ligji;</p> <p>4.3 ushtron detyrën e udhëheqësit në institucionin publik shëndetësor në kundërshtim me dispozitat e nenit 41 paragrafi 2 të këtij ligji;</p> <p>4.4 ushtron veprimtarinë shëndetësore pa licencë valide të punës në kundërshtim me nenin 64 paragrafi 3 të këtij ligji;</p> <p>4.5 ushtron kujdesin shëndetësor duke mos iu përmbajtur</p>	<p>provisions in article 41 paragraph 4, on illegal referral;</p> <p>3.3 Six (6) months upon violation of provisions in article 51 paragraph 2, by not reporting the data in compliance with this law;</p> <p>3.4 One (1) year upon violation of provisions in article 41 paragraph 5 receiving illegal financial or other award.</p> <p>4. Health professional shall be punished by the fine of 1000 Euros up to 2000 Euros in cases when he:</p> <p>4.1. Undertakes treatment without consent of the citizen or resident or his authorized representative, violating provisions of the sub-legal act from Article 4 with the exception of the emergent cases when their lives are at risk;</p> <p>4.2. Offers medication for the citizen or resident without the receipt against the provisions in article 26 paragraph 2 of this law;</p> <p>4.3. Acts the leading duties in the public health sector against the provisions in article 41 paragraph 2 of this law;</p> <p>4.4. Exercises healthcare activities without a valid working license, in accordance with article 51 of this law;</p> <p>4.5. Exercises healthcare violating</p>	<p>3.3 Šest (6) meseci zbog kršenja člana 51 stav 2, zbog neizveštavanja podataka u saglasnosti sa ovim zakonom;</p> <p>3.4 Jedne (1) godine zbog kršenja člana 41 stav 5 o primanju nezakonite finansijske ili druge nagrade.</p> <p>4 Zdravstveni profesionalac će biti kažnjen kaznom od 1000€ do 2000€ u slučajevima kada:</p> <p>4.1 Poduzima lečenje bez saglasnosti građanina ili njegovog autoriziranog predstavnika, kršeći odredbe podzakonskog akta iz člana 4 ovog Zakona, osim u slučajevima hitnih stanja kada su njihovi životi ugroženi;</p> <p>4.2 Nudi građaninu lekove bez recepta u suprotnosti sa odredbama člana 26 stav 2 ovog Zakona;</p> <p>4.3 Obavlja dužnost rukovodeće ličnosti u javnoj zdravstvenoj instituciji u suprotnosti sa članom 41 stav 2 ovog Zakona;</p> <p>4.4 Obavlja zdravstvenu delatnost bez validne radne dozvole u suprotnosti sa članom 64, stav 3 ovog Zakona ;</p> <p>4.5 Obavlja zdravstvenu zaštitu kršeći etičke i profesionalne principe;</p>
---	---	--

<p>parimeve etike dhe profesionale; 4.6 ofron barin për shfrytëzuesin e shërbimeve shëndetësore pa recetë, në kundërshtim me nenin 60 paragrafi 2 i këtij ligji. 4.7 përcakton çmimin e shërbimit shëndetësor jashtë çmimores së përcaktuar.</p> <p>5. Mjetet e mbledhura nga gjobat paraqesin të hyra në Buxhetin e Kosovës në pajtim me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>ethical and professional principles; 4.6. Offers the medicament for the healthcare user without a receipt, against article 60 paragraph 2 of this law. 4.7. Implements fees for services, violating approved price-list.</p> <p>5. Funds collected by fines are income of the Kosovo Budget in compliance with the legislation in force.</p>	<p>4.6 Nudi lekove bez recepta za korisnike zdravstvenih usluga u suprotnosti sa odredbama člana 60 stav 2 ovog Zakona; 4.7 Određuje cene usluga u suprotnosti sa usvojenim cenovnikom.</p> <p>5 Finansijska sredstva sakupljena od kazni će biti uplaćena u budžet Kosova, u skladu sa zakonodavstvom na snazi.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 88 Ndalimi i punës së institucionit shëndetësor</p> <p>1. Institucioni shëndetësor dënohet me marrje të licencës së punës në kohëzgjatje prej një (1) viti në rastet, si në vijim: 1.1 Shkelje të dispozitave të nenit 41 paragrafi 1, duke lejuar profesionistin shëndetësor që njëkohësisht të punojë në institucionin publik dhe privat shëndetësor. 1.2 Shkelje të dispozitave të nenit 41 paragrafi 5, duke dhënë shpërblime jo të ligjshme për profesionistët shëndetësorë; 1.3 shkelje të nenit 49 paragrafi 2, duke mos siguruar të dhënat për</p>	<p style="text-align: center;">Article 88 Work prohibition of the healthcare institution</p> <p>1. Healthcare institution is punished with revocation of license in the time span of one (1) year in the following cases: 1.1 Violation of provisions in article 41 paragraph 1 by allowing healthcare professional simultaneous work in a public and private healthcare institution. 1.2 Violation of article 41 paragraph 5, by giving illegal awards to the health professionals; 1.3 Violation of article 49 paragraph</p>	<p style="text-align: center;">Član 88 Zabrana rada zdravstvene ustanove</p> <p>1. Zdravstvenoj instituciji zabranjuje se rad u vremenskom trajanju od jedne (1) godine u sledećim slučajevima: 1.1 Kršenje odredbi člana 41 stav 1, u slučaju omogućavanja zdravstvenom stručnjaku da istovremeno radi u javnoj i privatnoj zdravstvenoj ustanovi; 1.2 Kršenja člana 41 stav 5 u slučaju davanja nezakonitih nagrada zdravstvenim stručnjacima; 1.3 Kršenja člana 49 stav 2 u slučaju neobezbeđivanja podataka za ZIS na</p>

<p>SISH të përcaktuara me këtë ligj;</p> <p>1.4 shkelje të nenit 64 paragrafi 3, duke lejuar profesionistët shëndetësorë që të punojnë pa licencë valide të punës.</p> <p>2. Institucionit shëndetësor ku në mënyrë të përsëritur konstatohen parregullsitë nga ana e organit të autorizuar me nenin 47 të këtij ligji i ndalohet puna.</p> <p>3. Vendimin për ndalimin e punës së institucionit shëndetësor nga paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i këtij neni e nxjerrë Ministria.</p> <p>4. Institucioni i kujdesit shëndetësor nga paragrafi 2 i këtij neni ka të drejtë në ankesë në pajtim me këtë Ligj.</p>	<p>2, by not ensuring the data for HIS, as set by this law;</p> <p>1.4 Violation of article 64 paragraph 3, by providing possibility for health professionals to practice without a valid working license.</p> <p>2. The healthcare institution at which continuously there are ascertained irregularities by the authorized organ from Article 47 of this law is prohibited to work.</p> <p>3. The decision of seize the work of a healthcare institution from paragraph 1 and paragraph 2 of this article is issued by the Ministry.</p> <p>4. The healthcare institution from paragraph 2 of this article has the right on appeal in compliance with the law.</p>	<p>način određen ovim Zakonom;</p> <p>1.4 Kršenja člana 64 stav 3 u slučaju dozvoljavanja vršenja zdravstvene delatnosti zdravstvenim stručnjacima bez validne radne dozvole.</p> <p>2. Zabranjuje se rad zdravstvenoj ustanovi u kojoj se neprestano konstatuju nepravilnosti od strane ovlašćenog organa iz člana 47 ovog Zakona.</p> <p>3. Odluku o zabrani rada zdravstvene ustanove iz stava 1 ovog člana donosi Ministarstvo.</p> <p>4. Institucija zdravstvene zaštite iz stava 2 ovog člana ima pravo na žalbu, u skladu sa ovim Zakonom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 89 Procedurat gjyqësore</p> <p>1. Qytetari ose banori ose organi i autorizuar mund të fillojë procedurën civile ose penale kundër institucionit shëndetësor ose/dhe profesionistit shëndetësor në rastet kur:</p> <p>1.1 procedura diagnostike ose terapeutike ndërmerret pa pëlqimin e shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore ose personit të autorizuar nga ai, në</p>	<p style="text-align: center;">Article 89 Court procedures</p> <p>1. The citizen, resident or the authorized body can initiate a civil or criminal procedure against a healthcare institution and/or a health professional, in the following cases:</p> <p>1.1 Diagnostic or therapeutic procedure is undertaken without the consent of the citizen or person authorized by him in</p>	<p style="text-align: center;">Član 89 Sudski postupci</p> <p>1. Građanin ili ovlašćeni organ može pokrenuti civilni ili krivični postupak protiv zdravstvene ustanove i/ili zdravstvenog stručnjaka u slučajevima kada:</p> <p>1.1 dijagnostička ili terapijska procedura je preduzeta bez saglasnosti korisnika zdravstvenih usluga ili ovlašćenog lica, suprotno odredbi člana 4 ovog Zakona,</p>

<p>kundërshtim me dispozitat e nenit 4 të këtij ligji, me përjashtim të rasteve emergjente kur vihet në rrezik jeta e tij;</p> <p>1.2 ndodhë vdekja, ose pa-aftësia e përkohshme ose e përhershme e shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore si pasojë e lëshimeve profesionale dhe organizative;</p> <p>1.3 shkelen dispozitat përkitazi me ndërprerjen e shtatzënisë nga neni 78 i këtij Ligji;</p> <p>1.4 shkelen dispozitat përkitazi me frytnimin e asistuar nga neni 80 i këtij Ligji.</p> <p>2. Dispozitat e procedurës penale zbatohen edhe në rastin kur personi i cili nuk është profesionistë shëndetësor ofron kujdes shëndetësor.</p>	<p>contradiction with provisions in Article 4 of this law, with the exception of emergent cases when life is endangered;</p> <p>1.2 Death, temporary, or permanent disability of the healthcare user as a result of professional and organizational failures;</p> <p>1.3 The provisions regarding the termination of pregnancy from Article 78 of this law are violated.</p> <p>1.4 The provisions regarding in vitro fertilization from Article 80 of this law are violated.</p> <p>2. The provisions of the criminal procedure apply also when a person who is not a health professional provides healthcare services.</p>	<p>izuzev u hitnim slučajevima kada im je ugrožen život.</p> <p>1.2 prouzrokuje smrt ili stalni invaliditet korisniku zdravstvenih usluga, kao rezultat stručnih i organizacionih propusta;</p> <p>1.3 krši odredbe u vezi prekida trudnoće iz člana 78 ovog Zakona;</p> <p>1.4 krši odredbe u vezi sa potpomognutom oplodnjom na osnovu člana 80 ovog Zakona.</p> <p>2. Odredbe krivičnog postupka primenjuju se u slučaju kada lice koje nije zdravstveni stručnjak pruža zdravstvenu zaštitu.</p>
<p style="text-align: center;">Kreu XXII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE</p> <p style="text-align: center;">Neni 90</p> <p>Institucionet shëndetësore si dhe personat juridik dhe fizik të cilët në pajtim me këtë ligj ushtrojnë veprimtari shëndetësore duhet të harmonizojnë organizimin, punën dhe aktet e përgjithshme me dispozitat e këtij</p>	<p style="text-align: center;">Chapter XXII INTERIM AND FINAL PROVISIONS</p> <p style="text-align: center;">Article 90</p> <p>Healthcare institutions, other juridical and physical entities exercising healthcare activities in compliance with this Law, shall harmonize the organization, work and their</p>	<p style="text-align: center;">Poglavlje XXII PRELAZNE I ZAVRŠNE ODREDBE</p> <p style="text-align: center;">Član 90</p> <p>Zdravstvene ustanove i druga fizička i pravna lica koja u skladu sa ovim Zakonom obavljaju zdravstvenu delatnost treba da usklade organizaciju, rad i opšte akte sa odredbama ovog Zakona u roku od 6 meseci od njegovog</p>

<p>ligji në afat prej 6 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi.</p> <p style="text-align: center;">Neni 91</p> <p>Deri në funksionimin e plotë të SISH, Ministria është përgjegjëse për grumbullimin e të dhënave të domosdoshme për përpilimin, mbikëqyrjen, dhe zbatimin e politikave dhe strategjive shëndetësore.</p> <p style="text-align: center;">Neni 92</p> <p>Ministria siguron zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi të Odave të profesionistëve shëndetësorë nga neni 71 i këtij ligji deri në themelimin dhe fillimin e funksionimit të tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 93</p> <p>1 Kontraktimi i shërbimeve me ofruesit e shërbimeve do të fillojë vetëm pasi që:</p> <p>1.1 të jetë definuar lista e shërbimeve që do të kontraktohen;</p> <p>1.2 të jetë përcaktuar çmimi i çdo shërbimi;</p> <p>1.3 të definohet vëllimi i shërbimeve që do të kontraktohen;</p> <p>1.4 të përcaktohet kostoja totale e shërbimeve që do të</p>	<p>general acts with the provisions of this Law within 6 months from the day this law enters into force.</p> <p style="text-align: center;">Article 91</p> <p>Until the functioning of the HIS, the Ministry is responsible for collection of the necessary data for developing, supervision, and implementation of health policies and strategies.</p> <p style="text-align: center;">Article 92</p> <p>The Ministry ensures the enforcement of the duties and competencies of the chamber of health professionals, from article 71 of this law until they are established and functioning.</p> <p style="text-align: center;">Article 93</p> <p>1. The contracting of services with providers will only be initiated after:</p> <p>1.1 the list of covered services is defined;</p> <p>1.2 the price for each item in the list has been set;</p> <p>1.3 the volume of covered services has been agreed;</p> <p>1.4 the total cost of covered services has been calculated and;</p>	<p>stupanja na snagu.</p> <p style="text-align: center;">Član 91</p> <p>Do punog funkcionisanja ZIS, Ministarstvo je nadležno za sakupljanje neophodnih podataka za sastavljenje i nadzor i sprovođenje politika i zdravstvenih strategija.</p> <p style="text-align: center;">Član 92</p> <p>Ministarstvo zdravstva obezbeđuje sprovođenje zadatka i odgovornosti Komora zdravstvenih stručnjaka iz člana 71 ovog Zakona do njenog osnivanja i funkcionisanja.</p> <p style="text-align: center;">Član 93</p> <p>1 Sklapanje ugovora o uslugama sa ponuđačima usluga će početi nakon:</p> <p>1.1 definisanja spiska usluga koje se trebaju ugovoriti;</p> <p>1.2 utvrđivanja cena svake usluge ;</p> <p>1.3 utvrđivanja obima usluga koje trebaju biti ugovorene;</p> <p>1.4 utvrđivanja</p>
---	---	--

<p>kontraktohen; dhe</p> <p>1.5 të alokohen mjetet financiare brenda alokimit buxhetor (pas kalkulimit të të hyrave nga bashkë-pagesat).</p> <p>2 Lista e barërave dhe materialeve harxhuese do të definohet dhe hynë në fuqi vetëm pasi që të vlerësohet ndikimi i saj fiscal dhe pasi që të jenë alokuar mjetet financiare brenda alokimit buxhetor (pas kalkulimit të të hyrave nga bashkë-pagesat).</p> <p>Neni 94 Qeveria, dhe Ministria do të miratojnë aktet ligjore dhe nën-ligjore të nevojshme për zbatimin e këtij Ligji.</p> <p>Neni 95 Me hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohen: Ligji i shëndetësisë Nr. 2004/4; Ligji Nr.03/L-124 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për shëndetësi; Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi Nr. 2004/50; dhe dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë Ligj.</p> <p>Neni 96 Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15)</p>	<p>1.5 the financing means have been allocated within the budget allocation (after accounting for co-payment income).</p> <p>2. The list of drugs and medical consumables shall be defined and enter into force only after their fiscal impact has been assessed and the financing means have been allocated within the budget allocation (after accounting for co-payment income).</p> <p>Article 94 The Government and the Ministry shall approve the legal and sub-legal acts required for the implementation of this law.</p> <p>Article 95 When entering into force, this law shall supersede the Law on Health No. 2004/4, Law No. 03/L-124 on amending and supplementing the Health Law, the Law on private healthcare services No. 2004/50 and legal provisions in contradiction with this law.</p> <p>Article 96 This law enters into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p>	<p>ukupnih troškova usluga koje trebaju biti ugovorene;</p> <p>1.5 dodeljenih sredstava u okviru budžetske alokacije sredstava (nakon obračuna prihoda od participacije);</p> <p>2 Spisak lekova i potrošnih materijala biće definisani i zakonski stupiti na snagu tek nakon njegovog procenjenog fiskalnog uticaja , nakon dodeljenih finansijskih sredstava unutar budžetske alokacije (nakon obračuna prihoda od participacije).</p> <p>Član 94 Vlada i Ministarstvo će odobriti zakonske i podzakonske akte za sprovođenje ovog Zakona..</p> <p>Član 95 Stupanjem na snagu ovog Zakona stavljaju se van snage: Zakon o zdravstvu br. 2004/4; Zakon br.03/L-124 o izmenama i dopunama Zakona o zdravstvu; Zakon o privatnoj delatnosti u zdravstvu br. 2004/50 i ostali zakonski propisi koje su u suprotnosti sa ovim Zakonom.</p> <p>Član 96</p>
---	--	---

<p>ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p>Jakup Krasniqi _____</p> <p>Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës.</p>	<p>Jakup Krasniqi _____</p> <p>The President of the Assembly of the Republic of Kosovo.</p>	<p>Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom listu Republike Kosova</p> <p>Jakup Krasniqi _____</p> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosova</p>
---	---	---

